

VENDIM
Nr. 654, datë 31.7.2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË
PYJORE “KRASTË-KRUJË”, KRUJË, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “SHPRESA-
AL” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat 9/a, 99/b, 99/c dhe 100/a të ekonomisë pyjore “Kraštë-Krujë”, Krujë, gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) ha, që do të përdoren nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të gurit gëlqeror në vendburimin “Picragë”, të hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e sipërmendur të regjistrohet në kadastrën minerare, në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pronësi publike.

3. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll, djerr” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të gurit gëlqeror” sipas kondicioneve të projektit të parashtruar dhe planimetrisë bashkëlidhur, në përputhje me kërkesat e akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi për fondin pyjor.

4. Shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., të paguajë për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor tarifat e llogaritura sipas lidhjes 4, bashkëlidhur vendimit nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k. të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 3 (tri) viteve, sipërfaqen 19 (nëntëmbëdhjetë) ha, fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Mënyra e pyllëzimit dhe grafiku i punimeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek punimet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet tyre.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të reregjistrohet fond pyjor sipas mënyrës së rehabilitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

Nr.	Emërtimi i	Ngastra	Sipërfaqja	Përdorimi i	Forma e	Funksioni
-----	------------	---------	------------	-------------	---------	-----------

	ekonomisë		që hiqet, ha	territorit	qeverisjes	kryesor
1	EP. Krastë-Krujë	9/a	2.4	Pyll	Shkurre	Prodhues
2	EP. Krastë-Krujë	99/a	11.50	Pyll	Trungishte	Prodhues
3	EP. Krastë-Krujë	99/c	2.6	Djerr	Nuk ka	Prodhues
4	EP. Krastë-Krujë	100/a	2.5	Pyll	Trungishte	Prodhues
	Totali		19.00			

